



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpallë:

FTESË PUBLIKE

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:

FURNIZIMI ME MEKANIZËM BUJQËSOR

Përkrahja e fermerëve me:

Nr.	Lloji i mekanizmit bujqësor	Sasia/copë
1	Freza 180 cm	60
2	Motokultivator me frezë 12 HP	30
3	Mbjellëse misri mekanike me plehërim	6

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
2. Çertifikata e bashkësisë familjare;
3. Vërtetimi i tatimit në pronë;
4. Raporti i pagesave direkte/subvencioneve 2026 (vlen vetëm për pajisjet 1 dhe 3);
5. Çertifikata e regjistrimit të fermerit-NIF-i. (të jetë i/e regjistruar si fermer para publikimit të thirrjes për aplikim)

Përparësitë:

Poena

- | | |
|--|------|
| 1. Familjet (aplikuesit) të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit | 10 |
| 2. Numri i antarëve të familjes (1-5 antarë- 5 pikë); (mbi 5 antarë -10 pikë) | |
| 3. Përparësi të aplikimit kanë aplikuesit femra | 10 |
| 4. Aplikuesit në zonat e thella rurale | 10 |
| 5. Vizita në terren | 0-50 |

Kushtet për aplikim

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit);
- Të jetë i/e regjistruar si fermer para datës së publikimit të thirrjes për aplikim;
- Të posedoj tokë të punueshme:
 1. Aplikuesit për **Freza 180 cm**, të kenë së paku 3 ha tokë të punueshme;
 2. Aplikuesit për **Motokultivator me frezë 12 HP**, të jetë kultivues i primeve apo kulturave të tjera intensive;
 3. Aplikuesit për **Mbjellëse misri mekanike me plehërim** të kenë së paku 3 ha tokë të mbjellura me misër.
- ❖ Fermerët përfitues do të marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit;
- ❖ Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me 70% të vlerës së projektit.

VËREJTJE: FERMERËT MUND TË PËRFITOJNË VETËM NË NJËRËN NGA MEKANIZMAT E LARTËCEKUR !

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datën 26.08.2026, ora 16:00.

Nr: 12-320/01-0046585126

Podujevë

6 Gusht 2026

